

Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë

BOTIMI I NËNTË

Tetor 2025



Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë, Botimi i Nëntë

Tetor 2025

©Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Prishtinë, Tetor 2025

Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve të Grupit për Studime Juridike dhe Politike, stafit, bashkëpunëtorëve ose përfaqësuesve të tyre. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme apo nga çfarëdo mjeti pa leje. Kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike për kërkesat e tilla.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

Rr. "Rexhep Luci" 16/1

Prishtinë 10 000, Kosovë

www.legalpoliticalstudies.org

office@legalpoliticalstudies.org

+381 38 234 456

RoLPIK është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e këtij Indeksi është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

RRETH ROLPIK

Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë (Rule of Law Performance Index in Kosovo - RoLPIK) është produkt i Grupit për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), i hartuar për të vlerësuar perceptimin qytetarë për punën e institucioneve të drejtësisë në Kosovë dhe të dhënat statistikore mbi efikasitetin e treguar në trajtimin e lëndëve gjyqësore.

RoLPIK ofron të dhëna të hapura dhe shërben si mekanizëm monitorimi. Deri më tani janë realizuar tetë (8) botime në të cilat analizohet e pasqyrohet puna e institucioneve të sistemit të drejtësisë në Kosovë si dhe ofrohen të dhëna mbi perceptimet dhe eksperiencat e qytetarëve të Kosovës në veprimtaritë e këtyre institucioneve përgjatë viteve.

Të dhënat mbi perceptimin publik për punën e institucioneve të sundimit të ligjit, të dhënat nga raportet e punës së sistemit gjyqësor dhe ndarjet buxhetore për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), nga viti 2013 deri në vitin 2024, i gjeni të publikuara në ueb faqen: <https://www.rolpik.org/>.

HYRJE

Institucionet e drejtësisë në Republikën e Kosovës vazhdojnë të mbesin në fokus të kritikave nga akterë të ndryshëm qoftë institucional por edhe nga organizatat e shoqërisë civile dhe publiku i gjerë. Ndër aspektet ku konsiderohet që sistemi i drejtësisë po dështon e nuk po ka rezultate të pritshme mbetet politika e ultë ndëshkimore, amnistimi i personave të profilit të lartë ose personave të lidhur me politikën, zvarritja e procedimit të rasteve, hetime jo profesionale, aktakuza jo të plota e të pabazuara dhe nivel i ultë i konfiskimit të pasurisë së fituar kundërligjshëm.

Padyshim, të gjitha këto ngecje në sistemin e drejtësisë nuk mund të i mveshen vetëm organeve dhe personave që merren me menaxhimin e tyre, pasi një pjesë e përgjegjësisë bie edhe tek pushteti ekzekutiv dhe ai legjislativ. Pushteti ekzekutiv duhet të mbahet përgjegjës për mungesë të vullnetit për bashkëpunim dhe inicim të reformave të mirëfillta brenda sistemit të drejtësisë, kurse Kuvendi – deputetët për anashkalimin e kërkesave buxhetore dhe ndarje jo të mjaftueshme të buxhetit për trupat që menaxhojnë me sistemin prokurorial e gjyqësor në vend – Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Ministria e Drejtësisë (MD) që mision ka përgatitjen dhe zbatimin i politikave dhe legjislacionit në fushën e drejtësisë, gjatë vitit 2024, ka iniciuar dhe zhvilluar një numër të konsiderueshëm të iniciativave me qëllim reformimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Padyshim, edhe gjatë vitit të kaluar kryetemat lidhur me reformën e premtuar në drejtësi ishin Vettingu, Byroja shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme dhe Ligji për KPK-në. Po ashtu, një vëmendje e posaçme i është kushtuar Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2021 - 2026 (SSL)¹

1 Ministria e Drejtësisë, Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026, në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/04/Strategjia-per-Sundimin-e->

dhe Deklaratës së Përbashkët të Zotimit (Deklarata e Zotimeve), si dokumente të cilat u hartuan në frymën e bashkëpunimit ndërinstytucional, por gjatë rrugës detyrimet e dala nga këto dy dokumente hasën në mungesë zbatimi si shkak i mungesës së vullnetit për bashkëpunim e bashkërendim të aktiviteteve dhe gjuhës se akterëve politik me tendencë ndikimi në pavarësinë e punës së gjyqësorit.

Përveç dështimit në realizimin e reformave kryesore në drejtësi, Ekzekutivi ndonëse me një mandat të plotë 4 vjeçar nuk arriti as të hartojë e të miratojë një dokument strategjik siç është Strategjia Kombëtare Kundër Korrupsionit, gjë e cila paraqet një fakt shtesë mbi seriozitetin e qasjes institucionale në raport me korrupsionin, si një nga dukuritë që determinon vlerësim negativ të vendit tonë në raporte vendore e ndërkombëtare për vite me radhë.

Prandaj, me qëllim që të vlerësohet se si i shohin qytetarët zhvillimet kryesore në sistemin e drejtësisë, sa u besojnë e sa i shohin efikase institucionet e drejtësisë në luftën kundër kriminalitetit, a shohin ndikim të politikës në këto institucione dhe a vlerësojnë që ka pasur përmirësim në 5 vitet e fundit etj, GLPS përmes UBO Consulting gjatë muajit qershor 2025, ka realizuar anketë me 1065 qytetarë të moshën mbi 18 vjeçare, të gjinive, komuniteteve dhe komunave të ndryshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Nga përgjigjet e të anketuarve, gjetjet kryesore në kuadër të Indeksit të Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë (RoLPIK) – Botimi i Nëntë, janë këto:

- 75.6% e të anketuarve konsiderojnë se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji;
- Të pyetur se cilat nga institucionet influencohen më shumë nga ndikimi politik, 35.1% e të anketuarve në vend të parë i vendosin Gjykatat, 34% e tyre

e shohin këtë ndikim në Prokurorinë e Shtetit ndërsa 17.7% tjerë vlerësojnë se Policia e Kosovës influencohet me shumë nga politika;

- 47.9% e të anketuarve besojnë se zyrtarët/punëtorët e institucioneve të drejtësisë kërkojnë/pranojnë ryshfet. Të pyetur se cilat institucione janë më të prirur për këtë fenomen, të anketuarit konsiderojnë se në vendin e parë janë gjykatat me 41.6%, më pas prokuroria me 37.6% dhe Policia me 18.8%;
- Ndërmjet vlerave 1 – aspak efektive dhe 5 – plotësisht efektive, me vlerën 3.7 të anketuarit vlerësojnë se Policia e Kosovës është institucioni më efektiv në luftën kundër korrupsionit. Lidhur me këtë çështje, Gjykata është vlerësuar me notën 2.9 kurse prokuroria me 2.8, që në vlerësimin qytetarë konsiderohen si institucionet më pak efektive në luftën kundër veprave penale të korrupsionit, edhe në raport me Mediat, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK);
- Pavarësisht mungesës së besimit në institucionet e drejtësisë, 78.6% e të anketuarve kanë theksuar se janë të gatshëm të raportojnë rastet e korrupsionit dhe veprat tjera penale. Ndërsa të pyetur se në cilin institucion do të raportonin, rreth 80.8% e të anketuarve kanë zgjedhur Policinë e Kosovës, 8.7% në APK, 4.9% në Media, 2.7% në prokurori dhe 2.3 në Gjykatë;
- Ndërmjet vlerës 1 – aspak i kënaqur dhe vlerës 5 – plotësisht i kënaqur, të anketuarit kanë theksuar se më të kënaqur janë me punën / performancën e Policisë së Kosovës (3.6), pastaj me gjykatat (2.7) dhe prokurorinë (2.7);
- Ndërmjet vlerave 1 – aspak nuk pajtohem dhe 5 - pajtohem plotësisht, nga përgjigjet e të anketuarve rezulton se me vlerë 3 është vlerësuar se institucionet e drejtësisë i trajtojnë njësoj personat/grupet e marginalizuara si: gratë, minoritetet,

- personat me aftësi të kufizuara, personat me të ardhura minimale;
- Të pyetur se cilat nga institucionet e Kosovës janë në gjendje të kryejnë detyrat/përgjegjësitë e tyre në mënyrë të pavarur, të anketuarit në vend të parë e vendosin Policinë e Kosovës 43.7% , më pas gjykatat 21.2% dhe rokurorinë me 18.3%;
 - Sa i përket vendimmarrjes së gjykatave, 39.1% e të anketuarve kanë vlerësuar që vendimet gjyqësore merren në faktet e disponueshme dhe në kornizën ligjore të vendit. 30.3% mendojnë se shumica e gjyqtarëve vendimet i marrin nën ndikimin e presionit të ushtruar nga interesat private/korrupsionit ndërsa 29% e tyre vlerësojnë se këto vendime merren nën ndikimin e presionit të ushtruar nga zyrtarët e lartë/personat me influencë politike;
 - 51.1% e 1065 të anketuarve vlerësojnë se nuk ka pasur përmirësim në sistemin e drejtësisë gjatë 5 viteve të fundit ndërsa 38% e tyre janë përgjigjur se kanë parë përmirësim në sistemin e drejtësisë. Këta të fundit kanë theksuar se gjyqësori më së shumti është përmirësuar në llogaridhënie dhe transparencë;
 - Ndërmjet vlerave 1 – aspak nuk pajtohem dhe 5 – pajtohem plotësisht, nga përgjigjet e të anketuarve me vlerësimin 3.3 është konstatuar se gjykatat dhe prokuroritë kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët prokurorët nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet, apo frikësimet;
 - Vetëm 2.8% e të anketuarve vlerësojnë që Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës shqiptojnë gjithmonë masa disiplinore apo degradim në pozitë ndaj gjyqtarëve / prokurorëve të cilët i shkelin rregullat apo procedurat;
 - Nga të dhënat e anketës rezultoi se vetëm 30% e personave që janë intervistuar kanë marrë / pranuar shërbime gjatë 5 viteve të fundit nga institucionet e drejtësisë (Policia, prokuroria, gjykata);
 - Të pyetur se cilat janë arsytet e mosrealizimit të iniciativave të Qeverisë së Kosovës (Ministritë së Drejtësisë), si procesi i Vettingut dhe Byroja për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, qytetarët vlerësojnë se arsye kryesore është mungesa e vullnetit politik (37.4%) dhe mungesa e koncensusit politik (18.3%);
 - Të anketuarit nuk e vlerësojnë plotësisht të sigurtë gjendjen e sigurisë në vend si rezultat i luftës në Ukrainë dhe tendencave për destabilizimin e situatës në komunat veriore të Kosovës. Kësisoj, ndërmjet vlerës 1 – aspak të sigurtë, dhe vlerës 5 – plotësisht të sigurt, nga mesatarja e përgjigjeve të të anketuarve rezultoi se nivelin e sigurisë në vend e vlerësojnë me vlerën 3.43;
 - Të pyetur se nga 1 – aspak meritore, deri në 5 – plotësisht meritore, sa konsideroni që janë të drejta dhe parandaluese dënimet për rastet e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, nga mesatarja e përgjigjeve të të anketuarve rezultati është 3;
 - Qytetarët e vlerësojnë pozitive digjitalizimin e ofrimit të shërbimeve të gjyqësorit – si mekanizmi për përcjelljen e statusit të lëndëve në Gjykatë dhe nxjerrja e Certifikatës mbi Dënimet Penale. Ku ndërmjet vlerës minimale 1 dhe asaj maksimale 5, digjitalizimi i shërbimeve të gjyqësorit është vlerësuar me notën 3.27;
 - Vetëm 6% e të anketuarve kanë deklaruar se janë aktualisht palë në procese gjyqësore, dhe pjesa më madhe e tyre janë në cilësi të palës së dëmtuar.
 - Ndërsa, nga analizimi i të dhënave statistikore nga puna e gjykatave dhe prokurorive në nivel vendi, dhe e ndarjeve buxhetore për KGJK-në dhe KPK-në, rezultoi se:

- Në vitin 2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) menaxhoi një buxhet rreth 35.8 milionë euro, që përbën 1% e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës. Ndërsa, Këshilli Prokurorial i Kosovës pati buxhet rreth 15.9 milion euro, apo 0.5% e buxhetit shtetëror.
 - Gjykatat (Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme, Gjykata e Apelit, shtatë gjykatat themelore dhe Gjykata Komerciale) trajtuan 452,706 lëndë dhe zgjodhën 187,047 lëndë, apo 41%. Gjatë vitit 2024 ato pranuan më shumë lëndë se sa arritën të përfundojnë, duke reflektuar një nivel efikasiteti prej 95%.
 - Gjykata Komerciale, si institucion gjyqësor i ri, ka zgjidhur 97% të lëndëve që ka pranuar në vit, duke shënuar përparim të madh krahasuar me vitin e parë të punës, 2022, kur përfundoi vetëm 50%;
 - Prokurori i Shtetit (Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës dhe shtatë prokuroritë themelore) trajtoi 150,204 lëndë gjatë vitit 2024 dhe ka zgjidhur vetëm 45,681, apo 30%. Ndërsa, në raport me rastet e reja, ky institucion tregoi efikasitet prej 99%, pra duke zgjidhur pothuaj gjitha lëndët që ka pranuar në vit;
 - Në vitin 2024, një gjyqtar i Gjykatës Themelore e pati për shqyrtim mesatarisht 1,366 lëndë, një gjyqtar i Dhomës së Posaçme 1,058 lëndë, një gjyqtar i Gjykatës Komerciale 883 lëndë, një gjyqtar i Gjykatës së Apelit 845 lëndë dhe një gjyqtar i Gjykatës Supreme 198 lëndë;
 - Një prokuror i Prokurorisë Themelores ishte i ngarkuar me mesatarisht 874 lëndë, një prokuror i Prokurorisë së Apelit me 865 lëndë, një prokuror i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me 130 lëndë, dhe një prokuror i Prokurorisë Speciale me 103 raste.
- Duke marrë parasysh nivelin e efikasitetit të treguar në vitin 2024, prokuroritë do të duhet të punojnë, me këtë ritëm, të paktën 2.4 vite, ndërsa gjykatat 3.3 vite, për të zgjidhur të gjitha lëndët që kanë në stok, po qe se gjatë kësaj periudhe nuk do të pranohet raste të reja.

METODOLOGJIA

RoLPIK – Botimi i Nëntë është bazuar në të dhënat parësore si perceptimi qytetar dhe ato dytësore si raportet zyrtare nga organet përgjegjëse dhe menaxhuese të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Ky botim i RoLPIK përcjell në përpikmëri metodologjinë e përdorur për botimet paraprake, dhe bazohet në dy lloje kryesore indikatorësh, të njohur si indikatorët e perceptimit dhe indikatorët strukturorë.

Indikatorët e perceptimit përfshijnë anketimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës gjatë muajit qershor 2025, të realizuara nga UBO Consulting. Anketa është reprezentative për vendin dhe në të kanë marrë pjesë qytetarë të gjinive, grupmoshave, nivelit të shkollimit, punësimit dhe të ardhurave ekonomike të ndryshme. Kësisoj, vlen të theksohet se në 19 pyetje dhe 4 nënpyetje me opsione të përgjigjeve të shumëfishta dhe rotative, janë anketuar 1065 qytetarë, ku 49% janë burra ndërsa 51% janë gra, të gjithë të moshës madhore mbi 18 vjeç. Sa i përket komponentes së etnisë, nga totali i të anketuarve, 75% janë shqiptarë, 14.1% serb, 10.9% nga komunitetet tjera jo-shumicë në Kosovë. Kurse sa i përket vendbanimit, 46.5% të të anketuarve vijnë nga zonat urbane dhe 53.5% jetojnë në zona rurale.

Kurse për të vlerësuar efikasitetin e punës në gjykata dhe prokurori janë mbledhur dhe analizuar të dhënat nga raportet zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovë (KGJK) dhe Prokurorit të Shtetit.² Më konkretisht, janë analizuar të dhënat për numrin e lëndëve të pranuar, lëndëve të trashëguara dhe atyre të zgjidhura brenda një viti në secilën gjykatë dhe prokurori me numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Indikatorët strukturorë reflektojnë mbi kapacitetet dhe resurset në dispozicion të prokurorive dhe gjykatave për të përmbushur mandatin e tyre, duke mundësuar në këtë mënyrë vlerësimin e efikasitetit të punës së tyre. Meqë nga janari i vitit 2013 ka hyrë në fuqi struktura e re e gjyqësorit, indikatorët bazohen në të dhënat e viteve 2013 – 2024. Duhet theksuar se vlerësimi dhe analizimi i numrit të lëndëve të zgjidhura apo të trashëguara brenda një viti në secilën gjykatë dhe prokurori, është bërë pa vlerësuar vështirësinë e zgjidhjes së tyre, apo ndarjen në departamente të ndryshme të gjykatave dhe prokurorive. Kjo pasi qëllimi kryesor në ndërtimin e indikatorëve strukturorë është që të vlerësojë efikasitetin total të punës së gjykatave dhe prokurorive si dhe të vlerësojë performancën individuale sasiore të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Ndërsa, të dhënat mbi buxhetin e ndarë për KGJK-në dhe KPK-në janë siguruar nga Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024.³

2 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetori – 2024, në https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/59474_KGJK_RAPORTI_PERGJITHSHEM_VJETOR_2024.pdf; Prokurori i Shtetit, Raporti Vjetor i Punës 2024, në <https://prokuroria-rks.org/wp-content/uploads/2025/06/Raporti-i-Prokurorit-te-Shtetit-per-vitin-2024.pdf>.


3 Ligji Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85052>.

**PERCEPTIMI
QYTETAR MBI
INSTITUCIONET
E SISTEMIT TË
DREJTËSISË**

NDIKIMI POLITIK NË SISTEMIN E DREJTËSISË


Ngjashëm me periudhat paraprake të vlerësimit, edhe në vitin 2025 qytetarët vazhdojnë të mendojnë që sistemi i drejtësisë vazhdon të jetë i ndikuar politikisht. Sipas tyre, zyrtarët dhe personat e lidhur me politikën vazhdojnë të kenë ndikimin në veprimtarinë e sistemit të drejtësisë duke bërë kështu që të njëjtit të kenë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji. Ky konstatim bazohet në përgjigjet e të anketuarve në pyetjen “A mendoni se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji?”. Nga përgjigjet e dhëna, rezulton se rreth 76% e qytetarëve vlerësojnë se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji. Ndërsa, vetëm 22.7% e tyre mendojnë se pavarësisht që personat mund të kenë ndikim politik, të njëjtit kanë gjasa të ndëshkohen në bazë të dispozitave ligjore.

A mendoni se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji?



Nga të anketuarit të cilët kanë pohuar se personat me ndikim politik kanë më pak gjasa të ndëshkohen nga ligji, 35% e tyre mendojnë se gjykatat janë institucionet që influencohen më së shumti nga ndikimi politik. Lidhur më këtë dukuri, prokuroria zë vendin e dytë me 34% dhe Policinë e Kosovës me 17.7%. GLPS, në raportin që trajton rastet e korrupsionit të nivelit të lartë për vitin 2024, ka konstatuar se rastet e kësaj natyre janë tejzgjatur në gjykatat e Kosovës dhe të akuzuarit kanë marrë dënime që nuk reflektojnë në të vërtetë me seriozitetin e veprave penale të kryera.⁴

Cilat nga këto institucione kanë më shumë prirje të ndikohen nga politika?




⁴ Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Institutional Treatment of Corruption Cases during 2024, në <https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2025/03/GLPS-Act-Now-Annual-Assessment-Corruption-in-Kosovo-2024.pdf>.

MITMARRJA

Insitucionet e drejtësisë vazhdojnë të perceptohen si aspak imune ndaj dukurisë së kërimit/pranimit të ryshfetit. Referuar të dhënave nga anketa rezulton se rreth 48% e qytetarëve të anketuar mendojnë se zyrtarët e institucioneve të drejtësisë pranojnë ose kërkojnë ryshfet. Padyshim, një situatë e tillë e perceptimit për prezencën e dukurisë së ryshfetit në institucionet që janë të thirrura në parandalimin, luftimin dhe gjykimin e korrupsionit, reflekton edhe në nivelin e ultë të besimit në pavarësinë dhe paanshmërinë e këtyre institucioneve ligjzbatuese.


Të anketuarit mendojnë që gjykatat me 41.6% prijnë si institucione në të cilat zyrtarët etyre kërkojnë dhe pranojnë ryshfet. Pas gjykatave, 37.6% e të anketuarve mendojnë se zyrtarët e Prokurorisë janë të ekspozuar përballë ryshfetit, kurse nga kjo dukuri më pak të ndikuar janë zyrtarët e Policisë së Kosovë. Mitmarrja e lartë nga zyrtarët e këtyre institucioneve, shihet se vazhdon të kontribuojë në krijimin e një imazhi negativ për sistemin e drejtësisë në Kosovë, i cili është në front të parandalimit dhe luftimit të kësaj dukurie negative.

Sipas mendimit tuaj, **zyrtarët/punëtorët** e institucioneve të drejtësisë (Policisë, Gjykatave, Prokurorisë, etj) a kërkojnë/pranojnë **mito**?



Zyrtarët/punëtorët e cilit institucion në vazhdim kërkojnë/pranojnë **mito**?

I anketuari mund të përgjigjet në më shumë se një përgjigje





EFEKTIVITETI NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

Ndonëse në mungesë të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit, qytetarët vlerësojnë se ka pasur hapa konkret në luftimin e dukurisë së korrupsionit në vendin tonë. Në perceptimin qytetar, Policia e Kosovës vazhdon të kryesojë listën e institucioneve më efektive në luftën kundër korrupsionit në vend. Ndërmjet vlerave 1 – aspak efektive dhe 5 – plotësisht efektive, me vlerën 3.7 të anketuarit vlerësojnë se Policia e Kosovës është institucioni më efektiv në luftën kundër korrupsionit. Lidhur me këtë çështje, gjykata është vlerësuar me notën 2.9 kurse prokuroria me 2.8, që në vlerësimin qytetarë konsiderohen si institucionet më pak efektive në luftën kundër veprave penale të korrupsionit, të listuara pas Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (3), mediave (3.2) dhe shoqërisë civile (3.1).

1 - Aspak i kënaqur dhe
5 - Plotësisht i kënaqur


Si i vlerësoni institucionet në vazhdim për efektiviteten në luftën kundër korrupsionit?




GATISHMËRIA PËR TË RAPORTUAR KORRUPSIONIN DHE VEPRAT TJERA PENALE

Pavarësisht përqindjes së ultë të besimit në institucionet e drejtësisë, qytetarët e Kosovës janë shprehur të gatshëm për të bashkëpunuar me to dhe për të raportuar rastet e korrupsionit zyrtar dhe veprat tjera penale. Të pyetur nëse do të ishin të gatshëm të raportonin një rast korrupsioni apo krimi, 78.6% e të anketuarve kanë theksuar se janë të gatshëm të raportojnë rastet e tilla të kriminalitetit. Nëse bëhet një krahasim i shpejtë me Botimin e 8-të të RoLPIK të publikuar në 2023, vërehet një rritje e vogël prej 3.9 pikë përqindje e trendit të qytetarëve të gatshëm për të raportuar korrupsionin.⁵ Gatishmëria e qytetarëve për të raportuar korrupsionin ka pasur një trend rritjeje në të gjitha botimet paraprake të vlerësimit, gjë që paraqet një tendencë gjithnjë e në rritje të aktivizimit qytetar për të kontribuar në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar në Kosovë. Megjithatë, vazhdon të mbetet shqetësues niveli i lartë i pakënaqësisë qytetare me efikasitetin e sistemit të drejtësisë në luftimin e këtyre dukurive negative.


Në qoftë se do të vërenit ndonjë rast të korrupsionit apo krimin (vjedhje, dhune, etj), a do të ishit të gatshëm ta raportonit?



Ndërsa, të pyetur se në cilin institucion do të raportonin korrupsionin apo krimin, rreth 80.8% e të anketuarve kanë zgjedhur raportimin në Policinë e Kosovës, 8.7% në APK, 4.9% në Media, 2.7% në Prokurori dhe 2.3% në Gjykatë. Ngjashëm me botimet e kaluara, Policia e Kosovës vazhdon të jetë institucioni më i besueshëm i qytetarëve për të raportuar veprat penale, ndërsa gjykata dhe prokuroria vazhdojnë të mbesin me përqindje dukshëm më të ulët në këtë drejtim.



Nëse po, në cilin institucion do ta raportonit?




⁵ GLPS, Indeksi i Performancës së Institucioneve të Sundimit të Ligjit në Kosovë – Botimi i tetë, 2023, në <https://legalpoliticalstudies.org/rule-of-law-performance-index-in-kosovo-edition-8/>.

SHËRBIMET NGA INSTITUCIONET E DREJTËSISË


Risi e anketës së realizuar në kuadër të Botimit të Nëntë të RoLPIK janë edhe pyetjet sa i përket përfshirjes së qytetarëve në procese gjyqësore. Ndër arsyt kryesore për trajtimin e kësaj çështje është fakti se vetëm në vitin 2024, gjykatat e rregullta të Republikës së Kosovës kanë qenë të ngarkuara më 452,706 lëndë. Një numër kaq i madh i lëndëve aktive në këto gjykata lë të nënkuptonte që 1 në 3 qytetarë të vendit kanë lëndë aktive në gjykata. Por, nga përgjigjet e të anketuarve rezulton se vetëm 6% e tyre janë aktualisht palë në procese gjyqësore. Kjo mund të interpretohet në atë se është prezente dukuria që një qytetar të ketë disa lëndë aktive që presin epilog nga ana e sistemit gjyqësor.

A jeni aktualisht palë në ndonjë proces gjyqësor?



Kurse, nga personat që janë përgjigjur se janë palë në procese gjyqësore, pjesa më madhe e tyre janë deklaruar në cilësi të palës së dëmtuar, apo 56.4% e tyre.

Nëse po, në çfarë cilësie jeni të përfshirë?



14%

I/e akuzuar

56.4%

I/e dëmtuar

15.3%


Paditës/e

14.3%

Dëshmitar/e

Po ashtu, anketa ka pyetur qytetarët lidhur me shërbimet tjera të marra nga institucionet e drejtësisë. Qëllimi i këtij indikator është të vlerësojë se deri në çfarë mase qytetarët e Kosovës pranojnë shërbime nga shërbime nga Policia, gjykata dhe prokuroria. 30% e të anketuarve kanë pohuar se kanë pranuar shërbime nga këto institucione gjatë periudhës 5 vjeçare të fundit.

A keni marrë/pranuar shërbime gjatë 5 viteve të fundit nga institucionet e drejtësisë (Policia, Prokuroria, Gjykata)?




KËNAQSHMËRIA E QYTETARËVE ME PERFORMANCËN E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Me këtë indikator është synuar të vlerësohet sesa institucionet e drejtësisë veprojnë në përputhje me pritshmërinë e qytetarëve dhe përgjegjësitë e tyre. Qytetarët janë pyetur lidhur me kënaqshmërinë me performancën e Policisë, Gjykatave dhe Prokurorisë, ku qytetarët patën mundësi të përgjigjen nga vlera 1, që korrespondon me aspak të kënaqur, deri në vlerën 5, plotësisht të kënaqur. Të dhënat tregojnë se Policia prin me pikë mesatare prej 3.6, kurse gjykatat dhe prokuroria me vlerësim mesatar me nga 2.7. Të dhënat e këtij viti përcjellin trendin e njëjtë sikurse botimet paraprake të RoLPIK pa ndonjë ndryshim thelbësor. Thënë këtë, mund të konstatohet se që nga botimi i fundit i realizuar në 2022, asnjëra nga këto institucione nuk gëzon ndonjë rritje të madhe në kënaqshmërinë qytetare me punën e tyre që nga ajo periudhë.



Sa jeni të kënaqur me punën/performancën e këtyre institucioneve?

1 – Aspak i kënaqur dhe
5 – Plotësisht i kënaqur




VLERËSIMI I SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA GJYQËSORI

Ky botim sjell si risi edhe matjen e opinionit publik mbi kënaqshmërinë e tyre për shërbimet digjitale që ofrohen nga gjyqësori, si mekanizmi për përcjelljen e statusit të lëndëve në Gjykatë dhe nxjerrja e Certifikatës mbi Dënimet Penale. Nga nivelet e vlerësimit prej 1 – aspak të kënaqur dhe 5 – plotësisht të kënaqur, 11.5% e të anketuarve janë shumë të kënaqur me ofrimin e këtyre shërbimeve, 4% nuk janë aspak të kënaqur, ndërsa shumica e tyre, 39.5% ndjehen neutral apo i vlerësojnë mesatarisht ato. Ky rezultat e bën të domosdoshme promovimin dhe lehtësimin e procedurave të mëtejme të shërbimeve të gjyqësorit që i ofrohen qytetarëve.

Si e vlerësoni ofrimin e shërbimeve të gjyqësorit - si mekanizmi për përcjelljen e statusit të lëndëve në Gjykatë dhe nxjerrja e Certifikatës mbi Dënimet Penale - në mënyrë digjitale

1 – Aspak i kënaqur dhe
5 – Plotësisht i kënaqur



TRAJTIMI I BARABARTË I QYTETARËVE NGA SISTEMI I DREJTËSISË


Ndërmjet vlerave 1 – nuk pajtohem aspak dhe 5 – pajtohem plotësisht, të anketuarit janë pyetur edhe rreth perceptimit të tyre se a i trajton barabartë sistemi i drejtësisë të gjithë qytetarët në vend. Në pyetjen e parashtruar për të anketuarit: “Ju lutem na tregoni se sa pajtoheni me deklaratën në vazhdim “Institucionet e drejtësisë i trajtojnë njësoj personat/grupet e marginalizuara si: gratë, minoritetet, personat me aftësi të kufizuara, personat

me të ardhura minimale”, nga përgjigjet e tyre rezultojnë se shumica e tyre, 39.2% pajtohen deri diku se institucionet e drejtësisë i trajtojnë barabartë personat/grupet e marginalizuara.

Ju lutem na tregoni se **sa pajtoheni** me deklaratën në vazhdim:

“Institucionet e drejtësisë i trajtojnë njësoj personat/grupet e marginalizuara si: gratë, minoritetet, personat me aftësi të kufizuara, personat me të ardhura minimale”


1 - Aspak nuk pajtohem; 2 - Nuk pajtohem;
3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem;
5 - Plotësisht pajtohem



PAVARËSIA NË VENDIMMARRJE

Funksionimi i plotë i së drejtës në një shtet mbështetet nga promovimi i parimeve si pavarësia dhe paanshmëria. Lidhur me pavarësinë institucionale, 43.7% e të anketuarit e kanë konsideruar Policinë e Kosovës si institucion që është i aftë të punojë dhe të kryejë përgjegjësitë e tij në mënyrë të pavarur. Për gjykatat numri i këtij besimi është më i ultë, 21.2% e të anketuarve e konsiderojnë atë si institucion që mund të kryejë punët e veta si e pavarur. Nga të dhënat e anketës, shihet se prokuroria vlerësohet si institucioni që më së paku besohet se veprimtarinë e saj e bazon në parimin e pavarësisë e paanshmërisë në raport me Policinë e gjykatat. E një pjesë e konsideruar prej 16.4% mendojnë se asnjëra nga institucionet e lartpërmendura nuk arrin të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë në mënyrë të pavarur.

Sipas mendimit tuaj, në praktikë, cilat nga **institucionet** e Kosovës në vazhdim janë në gjendje të kryejnë detyrat/përgjegjësitë e tyre në mënyrë të **pavarur**?



Perceptimi i qytetarëve për vitin 2025 tregon se gjyqtarët në shumicën e rasteve vendimet e tyre i marrin nën ndikimin e presionit. Të dhënat e anketës tregojnë se vetëm 40% e qytetarëve janë të mendimit se gjatë marrjes së vendimit shumica e gjyqtarëve në Kosovë bazohen në faktet e disponueshme dhe në kornizën ligjore të vendit. Kurse, rreth 60% e të anketuarve vlerësojnë se vendimmarrja gjyqësore nuk bazohet në legjislacion por bëhet nën ndikimin e presionit të ushtruar nga interesat privat/korrupsionit (30.3%) dhe nën ndikimin e presionit të ushtruar nga zyrtarët e lartë/personat me influencë politike (29%).

Sipas mendimit tuaj, gjatë marrjes së vendimit shumica e **gjqtarëve** në Kosovë bazohen më shumë në:


Në faktet e disponueshme dhe në kornizën ligjore të vendit

39.1%




Në ndikimin e presionit të ushtruar nga interesat privat/korrupsionit

30.3%




Në ndikimin e presionit të ushtruar nga zyrtarët e lartë/ personat me influencë politike

29%



Tjetër

1.5%



PËRMIRËSIMI I GJYQËSORIT

Ndonëse vitet e fundit kishte një numër të madh të iniciativave me qëllim kryesor sigurimin e mbarëvajtjes dhe rikthimin e besimit të qytetarëve në drejtësi, ende më shumë se gjysma e qytetarëve (53%) mendojnë të kenë vërejtur përmirësim në sistemin e drejtësisë. Kurse 38% e të anketuarve kanë vlerësuar se sistemi i drejtësisë është përmirësuar në 5 vitet e fundit, ndërsa, 11% e të anketuarve kanë zgjedhur të mos përgjigjen apo kanë vlerësuar se nuk e din nëse ka pasur përmirësime në sistemin e drejtësisë apo jo.

Sipas mendimit tuaj, a është **përmirësuar** sistemi i drejtësisë gjatë 5 viteve të fundit?




Po **38%** Jo **51.1%** Nuk e di/ Pa përgjigje **10.9%**



Nga përqindja e të anketuarve që kanë pohuar se sistemi gjyqësor është përmirësuar, pjesa më e madhe e tyre (31.4%) mendojnë që sistemi i drejtësisë tashmë është më transparent dhe llogaridhënës. Ky perceptim qytetarë mund të lidhet me vendimet e KGJK-së për hapjen e gjyqësorit në raport me publikun, transmetimin online të mbledhjeve të Këshillit, Asamblesë së Kryetarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës të gjykatave, publikimin e vendimeve të kryetarëve të gjykatave mbi ankesat disiplinore ndaj gjyqtarëve, konferencat më të shpeshta për media, përfshirjen e monitorimit gjatë zhvillimit të proceseve rekrutuese etj.

Nëse po, cili nga këto **dimensione** të sistemit të drejtësisë është **përmirësuar** më së shumti?



31.4%

Llogaridhënia dhe transparencia

27.1%

Mbyllja/zgjidhja më e shpejtë e rasteve

19%

Ndikim më i vogël i politikanëve mbi gjyqtarët

22.1%

Hetimi i rasteve të korrupsionit

0.4%


Tjetër

DISIPLINIMI DHE KUSHTET E PUNËS SË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

Sikurse në botimet paraprake, pjesë e analizës është edhe vlerësimi i perceptimit qytetarë për masat disiplinore deri në largim nga puna ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve për shkelje të rregullave apo procedurave dhe për kushtet në të cilat punojnë gjyqtarët dhe prokurorët. Në pyetjen se a ka gjasa që të merren masa disiplinore apo degradim në pozitë ndaj gjyqtarëve/prokurorëve të cilët i shkelin rregullat apo procedurat, shumica e të anketuarve kanë vlerësuar se këto masa aplikohen rrallë ose ndonjëherë. Kurse vetëm 2.8% vlerësojnë se KGJK dhe KPK shqiptojnë masa disiplinore ndaj gjyqtarëve/prokurorëve kur ata shkelin rregullat ose procedurat gjatë kryerjes së detyrave zyrtare. Pra, në perceptimin qytetarë, sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial nuk kanë një qasje të qëndrueshme dhe sistemike në procesin e disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve që shkelin rregullat dhe procedurat gjatë punës së tyre.

Tutje, të anketuarit janë pyetur se ndërmjet vlerave 1 – aspak nuk pajtohem dhe 5 – pajtohem plotësisht, se a vlerësojnë

Sipas mendimit tuaj, a ka gjasa që të merren masa disiplinore apo degradim në pozitë ndaj gjyqtarëve/prokurorëve të cilët i shkelin rregullat apo procedurat?




se gjykatat dhe prokuroritë kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët dhe prokurorët nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet apo frikësimet. Nga anketa rezultoi se 44% të qytetarëve të anketuar pajtohen mesatarisht se këto institucione kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët/prokurorët nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet, apo frikësimet.

Ju lutem na tregoni se sa pajtoheni me deklaratën në vazhdim: “Gjykatat/prokuroritë kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët/prokurorët nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet, apo frikësimet”

Ju lutem na tregoni se **sa pajtoheni** me deklaratën në vazhdim:

“Gjykatat/prokuroritë kanë mjete dhe burime të nevojshme për të mbrojtur gjyqtarët/prokurorët nga kërcënimet, ngacmimet, sulmet, apo frikësimet”

1 - Aspak nuk pajtohem; 2 - Nuk pajtohem;
3 - Pajtohem pjesërisht; 4 - Pajtohem;
5 - Plotësisht pajtohem



VETTINGU DHE KONFISKIMI I PASURISË SË PAJUSTIFIKUESHME NË PROCEDURË CIVILE

Në diskursin publik, Vettingu në sistemin e drejtësisë dhe krijimi i Byrosë që do merrej veçanërisht me verifikimin dhe konfiskimin civil të pasurisë së pajustificueshme kanë vazhduar të diskutohen si dy nga reformat kryesore që do kontribuonin në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Duke qenë se asnjëra nga to nuk është jetësuar ende, përkundër përpjekjeve nga institucionet relevante, në këtë botim të

RoLPIK, qytetarët janë pyetur pikërisht mbi perceptimin e tyre se pse këto dy reforma të rëndësishme nuk u realizuan deri tani. Nga anketa rezultoi se pengesa kryesore, sipas qytetarëve, ka qenë mungesa e vullnetit politik (37.4%), e pasuar nga mungesa e konsensusit politik (18.3%) dhe vonesat e Gjykatës Kushtetuese në vlerësimin e projektligjeve (16.8%).

Cilat mendoni se janë arsyet e mosrealizimit deri më tani të iniciativave të qeverisë së Kosovës (Ministritë së Drejtësisë), si procesi i Vettingut dhe Byroja për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme?



18.3%

Mungesa e konsensusit politik

37.4%

Mungesa e vullnetit politik

11.8%

Draftimi jo adekuat i legjislacionit

16.8%

Vonesat në vlerësimin e kushtetueshmërisë së projektligjeve

0.7%

Tjetër


15%

Nuk e di/ Refuzoj të përgjigjem

NIVELI I SIGURISË NË VEND

Në botimin paraprak të RoLPIK-ut, është shtuar për herë të parë pyetja lidhur me situatën e sigurisë në vend. Kjo pyetje vazhdon të jetë pjesë e vlerësimit marrë shkas nga rastet e evidentuara të incidenteve si ngritja e barrikadave në veri të vendit. Në shtator të vitit 2023 ndodhi sulmi terrorist në Banjska⁶ Një vit më vonë, u sulmua edhe infrastruktura kritike e kanalit të ujit "Ibër Lepenci" në nëntor të vitit 2024.⁷ Në këtë botim, nga qytetarët që kanë marrë pjesë në anketë është kërkuar të përgjigjen në pyetje se nga 1 në 5, ku vlera 1 nënkupton që qytetarët e vlerësojnë aspak të sigurtë nivelin e sigurisë në vend, kurse vlera 5 nënkupton se e vlerësojnë plotësisht të sigurtë gjendjen e sigurisë në Kosovë. Nga të dhënat e anketës rezultoi se qytetarët e Kosovës vlerësojnë se gjendja e sigurisë në vend është mbi mesatare, duke e vlerësuar gjendjen e sigurisë në vlerën 3.43.

Në një shkallë nga 1 deri në 5
(1 – aspak dhe 5 – plotësisht),
si i vlerësoni nivelin e sigurisë në vend?



6 Dukagjini, Serbia sulmoi në Banjskë, Radojiciq foli në telefon me Vuçiç-in gjatë ditës, në <https://www.dukagjini.com/serbia-sulmoi-ne-banjske-radojiciq-foli-ne-telefon-me-vucic-in-gjate-dites/>.

7 Policia e Kosovës, Komunikatë për Media "Sulmohet infrastruktura kritike e kanalit të ujit "Ibër Lepenci", në <https://www.kosovopolice.com/sulmohet-infrastruktura-kritike-e-kanalit-te-ujit-iber-lepenci-napad-na-kriticnu-infrastrukturu-kanala-za-vodu-ibar-lepenac-critical-infrastructure-of-the-iber-lepenci-water-canal-atta/>.

BESUESHMËRIA NDAJ DHOMAVE TË SPECIALIZUARA TË KOSOVËS

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSP) janë themeluar me qëllim për të gjykuar krimet e pretenduara që janë kryer gjatë dhe pas luftës në Kosovë të viteve 1998 – 1999. Baza ligjore për krijimin e këtyre dhomave është Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.⁸ Edhe pse janë pjesë e sistemit gjyqësor kosovar, ato kanë selinë në Hagë të Holandës dhe përbëhen kryesisht nga staf ndërkombëtar, në mënyrë që të sigurohet pavarësia dhe paanshmëria në proces gjyqësor.⁹ Aktualisht, DHSP ndodhet në në fazën e paraqitjes së provave të Mbrojtjes në rastin Thaçi dhe të tjerët, një ndër proceset më të rëndësishme që po zhvillohen në këtë gjykatë.¹⁰


Sa i përket besueshmërisë së qytetarëve ndaj këtij institucioni, rezultatet e anketës tregojnë një mesatare prej 2.56, në një shkallë nga 1 deri në 5. Kjo tregon se opinioni publik mbetet mjaft i ndarë dhe skepticismi ndaj DHSP është i pranishëm.

8 Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, në <https://gzkrks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11036>.

9 Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës, në <https://www.scp-ks.org/sq>.

10 Koha, ZPS-ja përfundoi paraqitjen e provave ndaj Thaçit dhe të tjerëve, në <https://www.koha.net/arberi/zps-ja-perfundoi-paraqitjen-e-provave-ndaj-thacit-dhe-te-tjereve>; Dhomat e Specializuara të Kosovës, Fillimi i paraqitjes së provave prej Mbrojtjes në gjykimin Thaçi dhe të tjerët për krime lufte, në <https://www.scp-ks.org/sq/fillimi-i-paraqitjes-se-provave-prej-mbrojtjes-ne-gjykimin-thaci-dhe-te-tjeret-krime-lufte>.

Në një shkallë nga 1 deri në 5 (1 – aspak dhe 5 - plotësisht), deri në çfarë mase i besoni Dhomave të Specializuara të Kosovës që të ofrojnë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe të pavarur?




DËNIMET NË RASTET E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS NË BAZA GJINORE

Viteve të fundit ka pasur shumë reagime dhe kritika ndaj sistemit të drejtësisë sa i përket trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, prandaj në këtë botim të RoLPIK–ut vazhdon të përfshihet edhe indikator i që mat perceptimin qytetarë mbi trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore nga ana e gjyqësorit, përfshirë këtu politikën e ndëshkueshmërisë dhe efektin e tyre në praktikë.

Nga anketa, e realizuar në qershor të 2025-ës, rezulton se ndërmjet vlerave 1 (aspak meritore) dhe 5 (plotësisht meritore), dënimet që shqiptohen ndaj të akuzuarve për dhunë në familje apo / dhe dhunë në baza gjinore janë meritore dhe parandaluese në vlerën 3. Pra, një mesatare e tillë lë të nënkuptohet se qytetarët ndajnë mendimin që duhet të kemi politikë ndëshkimore më efektive dhe dënime më të larta ndaj të gjithë atyre që ushtrojnë dhunë brenda marrëdhënies familjare apo në rastet kur viktimat janë sulmuar mbi baza gjinore, në mënyrë që rastet e tilla të parandalohen në të ardhmen. Megjithatë, duket se gjykatat u japin më shumë prioritet këtyre rasteve.

GLPS, lidhur me rastet e dhunës në familje, ka gjetur se 98.2% e rasteve që ka analizuar janë aktgjykime dënuese dhe 1.7% e tyre janë aktgjykime refuzuese.¹¹

Në një shkallë nga 1 deri në 5 (1 – aspak dhe 5 - plotësisht), sa meritore (parandaluese) konsideroni që janë dënimet për rastet e dhunës në familje/baza gjinore?



Në botimin e nëntë të RoLPIK, vlerësimi i punës së sistemit të drejtësisë u bazua në analizën e raporteve zyrtare të gjykatave dhe prokurorive të publikuara për vitin 2024. Këto raporte përfshijnë të dhëna mbi numrin e lëndëve të zgjidhura, efikasitetin e punës, ngarkesën e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

11 GLPS, Trajtimi insitucional i rasteve të dhunës në familje, në <https://legalpoliticalstudies.org/institutional-treatment-of-domestic-violence-cases-july-2023-june-2024/>.

VLERËSIMI I PUNËS SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Vlerësimi i punës së sistemit të drejtësisë

Në botimin e nëntë të RoLPIK, vlerësimi i punës së sistemit të drejtësisë u bazua në analizën e raporteve zyrtare të gjykatave dhe prokurorive të publikuara për vitin 2024. Këto raporte përfshijnë të dhëna mbi numrin e lëndëve të zgjidhura, efikasitetin e punës, ngarkesën e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Analiza e sistemi gjyqësor u fokusua të punësimi i institucioneve kryesore: Gjykata Supreme të Kosovës (GJS), Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), Gjykata e Apelit të Kosovës (GJA), shtatë gjykatat themelore (GJTH) dhe Gjykata Komerciale (GJK). Ndërsa, vlerësimi i punës së sistemit prokurorial është ndalur te Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), Prokuroria e Apelit (PA), Prokuroria Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) dhe shtatë prokuroritë themelore (PTH).

Indikatorët e përdorur për këtë vlerësim masin vetëm pjesën sasiore të punës së gjykatave dhe prokurorive gjatë një viti kalendarik; ata nuk pasqyrojnë as nivelin e vështirësisë së rasteve, as mënyrën e trajtimit të tyre. Përveç kësaj, analiza shqyrton edhe ndarjen e buxhetit, për të kuptuar në çfarë mase është priorizuar sistemi i drejtësisë në raport me buxhetin e përgjithshëm së Republikës së Kosovës për vitin 2024.

PERFORMANCA E PROKURORIVE

Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve

Sistemi prokurorial i Kosovës, i përbërë nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorisë Speciale, Prokurorisë së Apelit, shtatë Prokurorive Themelore, gjatë vitit 2024 ka pasur në punë gjithsej 150,204 lëndë. Nga to, 99,523 ishin lëndë të trashëguara nga vitet paraprake, ndërsa 50,681 prokuroria i ka pranuar si raste të reja.¹¹

Gjatë këtij viti, prokuroritë kanë arritur të zgjidhin 45,481 lëndë, që përbën 90% të rasteve të pranuar të reja, por vetëm 30% të totalit të lëndëve në punë. Ndërsa në vitin 2023, sistemi prokurorial në tërësi kishte 141,230 kallëzime penale në punë dhe ka arritur të zgjidhë 41,973 (30% e totalit), në raport me rastet e reja, kishte arritur një efikasitet prej 81%. Nëse ky trend vazhdon, prokurorive do t'u duhej të trajtojnë pothuajse trefishin e lëndëve brenda një viti dhe të mos pranojnë asnjë rast të ri, në mënyrë që të përfundojnë të gjitha lëndët pa i bartur në vitin vijues. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur përqindjet e efikasitetit për secilën prokurori. Efikasiteti është llogaritur duke krahasuar numrin e lëndëve që kanë arritur të përfundojnë prokuroritë, në raport me numrin e lëndëve që ato kanë pranuar brenda vitit kalendarik.

Prokurorii Shtetit në tërësi ka shënuar efikasitet prej 90% gjatë vitit 2024. Më të suksesshmet ishin Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Prokuroria e Apelit, të dyja me nga 100% efikasitet, duke i përmbyllur pothuaj të gjitha rastet e pranuar. Në anën tjetër, Prokuroria Speciale, paraqiti nivelin më të ulët të efikasitetit, duke zgjidhur vetëm 62% të rasteve, 349 nga 567 lëndë të pranuar në vit.

Ndërkohë, shtatë prokuroritë themelore së bashku, me numrin më të madh të rasteve në punë, kanë përfunduar 34,613 nga 39,580 lëndë, apo 87% të tyre. Po ta krahasojmë këtë shifër me dy vitet paraprake, e cila në 2023 ishte 76% efikasitet dhe në 2022 ishte 84%, vërejmë një trend rritjeje të efikasitetit këtë vit nga prokuroritë themelore. Mirëpo, sipas të dhënave në indikatorin e e mëposhtëm, rritja nga viti 2023 mund të jetë rezultat i numrit më të madh të prokurorëve, pasi që prokuroritë themelore, në vitin 2024 kanë pasur 8 prokurorë më shumë se sa në vitin 2023.

11 Prokurori i Shtetit, Raporti Vjetor i Punës 2024, në <https://prokuroria-rks.org/wp-content/uploads/2025/06/Raporti-i-Prokurorit-te-Shtetit-per-vitin-2024.pdf>.

Tabela 1. Përqindja e efikasitetit të Prokurorit të Shtetit në zgjidhjen e lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar (2013 – 2024)

Viti	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit	Prokuroria Speciale	Prokuroria e Apelit	Prokuroritë Themelore
2024	100	62	100	87
2023	101	87	100	76
2022	100	75	100	84
2021	100	70	102	99
2020	100	153	100	118
2019	100	59	116	153
2018	102	105	99	127
2017	98	93	100	112
2016	101	192	100	112
2015	102	125	100	94
2014	96	51	100	71
2013	101	94	100	80

Ngarkesa e Prokurorëve me lëndë

Ky indikator mat ngarkesën mesatare të një prokurori brenda një viti, duke llogaritur numrin total të lëndëve në punë në raport me numrin e përgjithshëm të prokurorëve. Numri i lëndëve në punë përfshin si rastet e bartura nga vitet paraprake, ashtu edhe ato që janë pranuar të gjatë vitit kalendarik.

Në vitin 2024, Prokurori i Shtetit kishte gjithsej 200 prokurorë aktivë. Nga ta, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit ka pasur gjithsej 8 prokurorë të punësuar, Prokuroria e Apelit 11, Prokuroria Speciale 24, dhe shtatë prokuroritë themelore së bashku kanë pasur 157 prokurorë. Mes këtyre të fundit, 50 prokurorë ishin në Prishtinë, 22 në Prizren, 17 në Pejë, 16 në Gjiilan, 18 në Ferizaj, 15 në Gjakovë dhe 19 në Mitrovicë.¹²

Sa i përket numrit të lëndëve gjithsej në punë, sistemi prokurorial kishte në punë gjithsej 150,204 kallëzime penale. Ky numër ndahet në: 1,036 lëndë apo kallëzime në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, 9,517 në Prokurorinë e Apelit, 2,460 në Prokurorinë Speciale dhe 137,191 në shtatë prokuroritë themelore.

Analiza e ngarkesës mesatare për prokuror, tregon se më të ngarkuarit në 2024 kanë qenë prokurorët e Prokurorisë Themelore me mesatarisht 874 lëndë për prokuror, të ndjekur nga prokurorët e Prokurorisë së Apelit, me nga 865 lëndë. Ndërsa, më pak të ngarkuar kanë qenë prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, me 130 lëndë dhe ata të Prokurorisë Speciale me 103 lëndë për prokuror.

¹² Prokurori i Shtetit, Raporti Vjetor i Punës 2024, në <https://prokuroria-rks.org/wp-content/uploads/2025/06/Raporti-i-Prokurorit-te-Shtetit-per-vitin-2024.pdf>.

Krahasuar me vitet e mëparshme, që nga viti 2018, vërehet një trend i qartë i uljes së ngarkesës për prokurorët në prokuroritë themelore. Megjithatë, numri i lëndëve për secilin prokuror mbetet i lartë, duke vënë në pah nevojën për vlerësime të mëtejme mbi mbi shpërndarjen dhe menaxhimin e rasteve në kuadër të sistemit prokurorial.

Tabela 2. Mesatarja e lëndëve që kanë pasur në punë prokurorët brenda një viti, paraqitur (2013 – 2024)

Viti	Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit	Prokuroria Speciale	Prokuroria e Apelit	Prokuroritë Themelore
2024	130	103	865	874
2023	158	133	1182	868
2022	160	128	1115	821
2021	154	129	1012	810
2020	136	128	1471	753
2019	151	146	1160	920
2018	142	116	1148	1047
2017	203	46	724	404
2016	234	72	880	506
2015	412	53	645	540
2014	155	50	549	463
2013	217	48	584	509

Buxheti i Këshillit Prokurorial të Kosovës për Vitin 2024

Analizimi i ndarjeve buxhetore tregon nivelin e prioritetit që institucionet e drejtësisë e gëzojnë brenda buxhetit të përgjithshëm të shtetit. Prioritizimi i sistemit prokurorial, garanton funksionimin më efikas të institucioneve, si dhe shërbime sa më profesionale dhe të qasshme për qytetarët.

Për vitin 2024, KPK-së i janë dedikuar mbi 17 milionë euro (17,265,867 euro) nga buxheti i shtetit, i cili ishte mbi 3 miliardë euro, më i larti ndonjëherë që nga viti 2013. Shuma e ndarë për KPK-në këtë vit, ishte po ashtu më e larta e regjistruar ndonjëherë.¹³ Ndarjet për këtë institucion kanë shënuar rritje të vazhdueshme, me përjashtim të vitit 2023, kur buxheti ra në 16 milionë euro, pas një rritjeje të mëparshme në vitin 2022 që kishte arritur 17 milionë euro.

Në terma përqindjeje, gjatë vitit 2024 KPK-së i janë ndarë 0.52% e buxhetit total shtetëror. KPK nuk ka arritur të marrë asnjëherë të marrë më shumë se 1% të shumës së përgjithshme. Edhe pse përqindja e shumës së ndarë ka rënë në vitet e fundit, kjo nuk është pasojë e uljes së mbështetjes buxhetore, po reflekton rritjen reale të buxhetit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, edhe fondet e KPK-së kanë pësuar rritje. Por, kjo nuk pasqyron domosdo një politikë të synuar për forcimin e sistemit prokurorial apo të bazuar në analiza të mirëfillta të nevojave të prokurorisë, pasi që jo të gjitha kërkesat buxhetore që KPK-ja i ka paraqitur janë miratuar.¹⁴

¹³ Ligji Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85052>.

Shpenzimet e KPK-së në vitin 2024 pasqyrojnë një përqendrim të madh në kosto të personelit. Pothuajse 66% e buxhetit (11,368,845 euro) është ndarë për paga dhe shtesa. Për mallra dhe shërbime janë ndarë 19% (3,292,892 euro) . Për shpenzime komunale vetëm 1.2% (199,630 euro). Ndërsa për shpenzime kapitale janë ndarë 14% (2,404,500 euro).

Kjo shpërndarje, me koncentrim në mbulim të pagave, lë hapësirë të kufizuar për investime që do të mund të përmirësonin në mënyrë të qëndrueshme funksionimin e sistemin prokurorial. Fondet e dedikuara për ngritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe stafit mbështetës, si dhe për investime tjera kapitale dhe teknologjike mbeten relativisht të ulëta.

Tabela 3. Buxheti i Këshillit Prokurorial të Kosovës (2013 – 2024)

Viti	Buxheti i KPK-së	Buxheti i Republikës së Kosovës	Shpërndarja në %
2024	17,265,867.00 €	3,302,323,022.00 €	0.52
2023	15,913,983.00 €	3,211,603,100.00 €	0.50
2022	17,144,178.00 €	2,735,749,600.00 €	0.63
2021	14,441,528.00 €	2,454,209,105.00 €	0.59
2020	15,021,836.00 €	2,356,860,915.00 €	0.64
2019	14,170,065.00 €	2,378,231,797.00 €	0.59
2018	11,092,826.00 €	2,080,480,837.00 €	0.53
2017	9,483,682.00 €	2,001,020,484.00 €	0.47
2016	8,013,619.00 €	1,678,709,487.00 €	0.48
2015	7,158,086.00 €	1,682,486,849.00 €	0.43
2014	6,872,000.00 €	1,589,324,952.00 €	0.43
2013	5,775,534.00 €	1,591,118,599.00 €	0.36

14 Telegrafi, KPK-ja ankohet se ekzekutivi nuk po iu merr parasysh kërkesat për shtim të stafit, në <https://telegrafi.com/kpk-ja-ankohet-se-ekzekutivi-nuk-po-iu-merr-parasysh-kerkesat-per-shtim-te-stafit/#:~:text=K%C3%ABshilli%20Prokurorial%20i%20Kosov%C3%ABs%2C%20po%20ankohet%20se%20Ministria,5%20ka%20vendosur%20tu%20plot%C3%ABsoj%C3%AB%20Ministria%20e%20Financave>.

PERFORMANCA E GJYKATAVE

Efikasiteti i gjykatave në zgjidhjen e lëndëve

Gjyqësori i Kosovës, i përbërë nga Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit, shtatë gjykatat themelore dhe Gjykata Komerciale, gjatë vitit 2024 kishte në punë gjithsej 452,706 lëndë. Ky numër përfshin 255,652 rastet e mbetura pa u përfunduar nga viti paraprak dhe 197,054 të pranuar të reja gjatë vitit.¹⁵

Gjatë vitit 2024, gjykatat kanë arritur të zgjidhin 187,047 lëndë ose 95% e lëndëve të reja të regjistruara. Megjithatë, në raport me totalin e lëndëve në punë, kjo përqindje bie në 41%. Si rezultat, në fund të vitit 2024 mbetën të pazgjidhura 265,659 lëndë, të cilat u bartën në vitin 2025.

Nga analiza e efikasitetit, e cila mat raportin mes lëndëve të pranuar dhe atyre të përfunduara brenda vitit, vërejmë se gjykatat themelore së bashku kanë shënuar një nivel efikasiteti prej 98%, duke arritur të përmbyllë pothuajse të gjitha rastet e pranuar në vit. Gjykata Komerciale ka arritur një rezultat të ngjashëm me 97% efikasitet, ndërsa Gjykata Supreme ka realizuar 93%. Gjykata e Apelit ka shënuar nivelin më të ulët të efikasitetit me 71%. Në anën tjetër, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e ka tejkaluar numrin e rasteve të pranuar, duke zgjidhur 224% të tyre. Ky rezultat e dallon këtë gjykatë nga të tjerat dhe tregon një kapacitet të lartë për adresimin e rasteve të mbetura nga vitet e mëparshme.

Në bazë të këtyre të dhënave, gjykatat përveç që nuk kanë arritur të zvogëlojnë barrën e lëndëve, në vitin 2024 kanë kontribuar në rritjen e barrës së mbetur për 10,007 lëndë më shumë të trashëguara se sa në vitin 2023. Për të zvogëluar këtë barrë gjykatave do tu duhet të zgjidhin më shumë se 100%-shin e lëndëve të ardhura në vit. Me këtë ritëm, me kushtin që nuk vjen asnjë lëndë e re në punë, sistemi gjyqësor do të arrijë të përmbyllë të gjitha lëndët e saj brenda 2.4 viteve.

Duke qenë se shumica e gjykatave, nuk kanë arritur të zgjidhin aq raste sa kanë pranuar, sfida kryesore për vitin 2025 dhe tutje mbetet menaxhimi i rasteve të trashëguara dhe shmangia e rritjes së mëtejme të barrës së lëndëve.

¹⁵ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetori – 2024, në https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/59474_KGJK_RAPORTI_PERGJITHSHEM_VJETOR_2024.pdf.

Tabela 4. Përqindja e efikasitetit të gjykatave në zgjidhjen e lëndëve në vit në raport me numrin e lëndëve të pranuar (2013 – 2024)

Viti	Gjykata Supreme	Dhoma e Posaçme	Gjykata e Apelit	Gjykatat Themelore	Gjykata Komerçiale
2024	93	224	71	98	97
2023	99	162	90	92	96
2022	114	165	91	76	50
2021	99	203	79	66	
2020	84	264	106	60	
2019	95	135	108	177	
2018	110	92	97	161	
2017	98	112	90	145	
2016	89	130	186	110	
2015	105	46	89	98	
2014	98	28	92	109	
2013	201	54	103	80	

Ngarkesa e gjyqtarëve me lëndë

Ky indikator tregon nivelin e ngarkesës së gjyqtarëve gjatë vitit 2024, pa marrë parasysh llojin apo kompleksitetin e rasteve. Ngarkesa matet duke ndarë numrin e përgjithshëm të lëndëve gjithsej në punë në gjykatë me numrin total të gjyqtarëve aktivë në vitin 2024, duke treguar kështu sa lëndë ka pasur detyrë të trajtojë një gjyqtar brenda vitit. Numri i lëndëve në punë përbëhet nga shuma e numrit të lëndëve të trashëguara nga vitet paraprahe dhe e numrit të lëndëve të pranuar të reja brenda periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2024.¹⁶

Siç u përmend edhe më lartë, gjykatat në tërësi kishin 452,706 lëndë në punë, të cilat u trajtuan nga 373 gjyqtarë të angazhuar në zgjidhjen e rasteve në gjykatë. Nga analiza e ngarkesës del se më të ngarkuarit ishin gjyqtarët e Gjykatave Themelore me mesatarisht nga 1,366 lëndë për kokë. Ata ndiqen nga gjyqtarët e Dhomës së Posaçme me 1,058 raste, gjyqtarët e Gjykatës Komerçiale me 883 raste, dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit me 845 lëndë për gjyqtar. Ngarkesën më të ulët e kishin gjyqtarët e Gjykatës Supreme, me vetëm 198 lëndë për gjyqtar.

¹⁶ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti Statistikor i Gjykatave Vjetori – 2024, në https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/59474_KGJK_RAPORTI_PERGJITHSHEM_VJETOR_2024.pdf.

Tabela 5. Mesatarja e lëndëve që kanë pasur në punë gjyqtarët (2013 – 2024)

Viti	Gjykata Supreme	Dhoma e Posaçme	Gjykata e Apelit	Gjykatat Themelore	Gjykata Komerçiale
2024	198	1058	845	1366	883
2023	147	1178	798	1379	910
2022	114	1246	642	1091	1005
2021	132	1267	649	896	
2020	99	1477	497	595	
2019	89	2070	552	899	
2018	86	1519	649	1330	
2017	106	1837	680	2224	
2016	88	1850	644	3187	
2015	83	1816	539	2848	
2014	75	2211	583	3080	
2013	121	821	558	3133	

Buxheti për Këshillin Gjyqësor të Kosovës gjatë vitit 2024

Në vitin 2024, KGJK u financua me 35.8 milionë euro, që përbën vetëm 1.08% e buxhetit të përgjithshëm shtetëror, i cili pati rreth 3.3 miliardë euro. Shikuar ndër vite, nga viti 2013 buxheti i KGJK-së ka shënuar rritje të vazhdueshme.¹⁷ Megjithatë, kjo rritje kryesisht reflekton rritjen e përgjithshme të buxhetit të shtetit dhe jo domosdo rezultat i politikave për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit gjyqësor në Kosovë. Gjykatat po ashtu, kanë parashtruar më shumë kërkesa rreth nevojave të tyre buxhetore, se sa që u janë miratuar.¹⁸

Menaxhimi mjeteve financiare brenda KGJK-së është orientuar kryesisht drejt shpenzimeve për personel. Rreth 70% e buxhetit (25 milionë euro) është alokuar për paga dhe shtesa. Për mallra dhe shërbime janë ndarë 15% (5 milionë euro), për shpenzime komunale janë ndarë 1% (450 mijë euro), për subvencione dhe transfere 1% po ashtu (500 mijë euro), ndërsa për investime kapitale është dedikuar 13% e buxhetit (4.7 milionë euro).

Nga kjo shpërndarje, vërejmë se pjesa më e madhe e mjeteve shkon për shpenzime të detyrueshme si pagat, ndërsa lë shumë pak hapësirë për projekte zhvillimore që mund të përmirësojnë funksionimin më afatgjatë të sistemit gjyqësor.

¹⁷ Ligji Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85052>.

¹⁸ Kallxo, Sa kërkuar dhe sa iu dha buxhet KGJK-së për këtë vit?, janar 2024, në <https://kallxo.com/lajm/sa-kerkuan-dhe-sa-iu-dha-buxhet-kgjk-se-per-kete-vit/#:~:text=N%C3%AB%20mbedhjen%20e%20sotme%20t%C3%AB%20K%C3%ABshillit%20Gjyq%C3%ABsor%2C%20nd%C3%ABr,m%C3%AB%20e%20Iart%C3%AB%20se%20buxheti%20i%20vitit%202023>.

Tabela 6. Buxheti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (2013 – 2024)

Viti	Buxheti i KGJK-së	Buxheti i Republikës së Kosovës	Shpërndarja në %
2024	35,806,910.00 €	3,302,323,022.00 €	1.08
2023	34,155,572.00 €	3,211,603,100.00 €	1.06
2022	32,183,896.00 €	2,735,749,600.00 €	1.18
2021	29,194,592.00 €	2,454,209,105.00 €	1.19
2020	29,821,540.00 €	2,356,860,915.00 €	1.27
2019	29,404,466.00 €	2,378,231,797.00 €	1.24
2018	23,495,024.00 €	2,080,480,837.00 €	1.13
2017	21,793,948.00 €	2,001,020,484.00 €	1.09
2016	20,465,770.00 €	1,678,709,487.00 €	1.22
2015	21,288,771.00 €	1,682,486,849.00 €	1.27
2014	20,833,483.00 €	1,589,324,952.00 €	1.31
2013	19,910,467.00 €	1,591,118,599.00 €	1.25

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Konkluzione dhe Rekomandime

Referuar të gjeturave nga anketa e realizuar në vitin 2025 dhe të dhënave të nxjerra bazuar në indikatorët strukturorë për vitin 2024, rezulton se institucionet e sundimit të ligjit, në Kosovë vazhdojnë të kenë mungesë të besimit qytetar dhe në pavarësi në vendimmarrje. Personat me ndikim politik amnistohen nga ligji kurse dukuria e mitmarrjes vazhdon të jetë prezente tek zyrtarët e këtyre institucioneve të sundimit ligjit.

Më shumë se gjysma e të anketuarve nuk kanë vërejtur përmirësime në sistemin e drejtësisë në 5 vitet e fundit, kurse sipas tyre arsyeja kryesore për mos realizimin e reformave në drejtësi mbetet vullneti politik. Pavarësisht nivelit të ulët të besimit dhe kënaqshmërisë me punën e këtyre institucioneve, qytetarët shprehen të gatshëm që të bashkëpunojnë dhe të raportojnë veprat penale të ndryshme që mund të kryhen në vendin tonë.

Niveli i sigurisë në vend vlerësohet i kënaqshëm pavarësisht tendencave të kohëpaskohshme për destabilizim në komunitatet veriore të Republikës së Kosovës. Qytetarët e vlerësojnë në nivel mesatar politikën ndëshkimore të gjykatave në rastet e dhunës në familje. Rreth 60% e të anketuarve vlerësojnë se vendimet gjyqësore nuk merren bazuar në fakte dhe ligj por të ndikuar nga interesat private ose nga politika.

KGJK dhe KPK gjatë vitit 2024 kanë marrë pjesë me vetëm 1.5% në buxhetin e përgjithshëm të vendit. Gjykatat treguan efikasitet të zgjidhjes së lëndëve në shkallën 95% kurse prokuroritë në shkallën 99%. Bazuar në numrin e lëndëve që kanë mbetur në punë më datë 1 janar 2025, prokurorive u nevojiten rreth 2 vite e gjysmë kurse Gjykatave rreth 3 vite e gjysmë, për t'i zgjidhur, me kusht që nuk do të pranohet raste të reja.

Rekomandime

Nga të dhënat që përmban Botimi i Nëntë i RoLPIK, ofrohen rekomandimet e mëposhtme.

- Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës

1. KGJK dhe KPK të hartojnë / zbatojnë politika për rritjen e profesionalizmit, pavarësisë, transparencës, llogaridhënies dhe komunikimit publik;
2. KGJK dhe KPK të promovojnë në publik punën e gjykatave dhe prokurorive, duke aplikuar edhe konferencat për media sidomos për rastet që kanë impakt më të madh në shoqëri;
3. Gjykatat dhe prokuroritë të dëshmojnë trajtim profesional, të barabartë dhe të drejtë të secilit rast, pavarësisht statusit të palëve në procedurë;
4. KGJK dhe KPK të fuqizojnë mekanizmat që trajtojnë aspektin e dukurisë së mitmarrjes nga ana e zyrtarëve të këtyre institucioneve;
5. Gjykatat dhe prokuroritë të vazhdojnë dhe të rrisin shkallën e efikasitetit të zgjidhjes së lëndëve, duke pasur për qëllim uljen lëndëve që kanë mbetur në punë për vite me radhë;

- Për Kuvendin e Republikës së Kosovës

1. Kryesia e Kuvendit dhe deputetët të distancohen nga përdorimi i gjuhës që ka për qëllim ndërhyrjen në pavarësinë e sistemit të drejtësisë dhe që cenon parimin e ndarjes së pushteteve;
2. Deputetët e Kuvendit të Kosovës të arrijnë konsensus për procedimin tutje të amendamenteve kushtetuese për realizimin e Vettingut në drejtësi;
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës, me rastin e miratimit të Ligjit për Ndarjet Buxhetore të sigurohet që buxheti i ndarë për KGJK dhe KPK të jetë konform kërkesave të tyre;
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës t'i trajtojë me seriozitet raportimet vjetore me shkrim që dorëzohen nga KGJK dhe KPK.

- Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

1. Kabineti Qeveritar të distancohet nga përdorimi i gjuhës që ka për qëllim ndërhyrjen në pavarësinë e sistemit të drejtësisë dhe që cenon parimin e ndarjes së pushteteve;
2. Ministria e Drejtësisë të trajtojë me kujdesin e duhur nismat për reformat në drejtësi, duke bashkëpunuar dhe i bashkërenduar këto aktivitete me sistemin e drejtësisë, shoqërinë civile dhe akterët e tjerë;
3. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet t'i trajtojë me prioritet të lartë kërkesat buxhetore që parashtrihen nga ana e KGJK-së dhe KPK-së.

Rreth RoLPIK

RoLPIK ka për qëllim kryesor të promovojë përmirësimin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe qytetarëve në kërkimin e përgjegjësisë mbi performancën e sistemit të drejtësisë, përmes monitorimit, konsultimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm.

Për më shumë rreth platformës RoLPIK vizitoni:

www.rolpik.org



RoLPIK është zhvilluar me mbështetjen e projektit rajonal "SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor" të zbatuar nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e këtij Indeksi është përgjegjësi e vetme e zbatuesve të projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

